

VENDIM
Nr. 609, datë 22.9.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.5.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, ‘SKELE–UJI I
FTOHTË’, BASHKIA VLORË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- Të dhënat e numrit rendor 52, në pronësi të bashkëpronarëve: Metushi, Merkaj dhe Rustemaj, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera shtesë, prej 984 067.2 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e shtatë pikë dy) lekësh e kësaj pasurie, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, ‘SKELË–UJI I FTOHTË, BASHKIA VLORË’”, TË NDRYSHUAR

NR. RENDOR NË VKM-në NR. 310, DATË 21.5.2014, TË NDRYSHUAR	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe (m ²)		Çmimi (lek/m ²)		Vlera (lek)			Shënime
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtesë	Banesë	
52	Bashkëpronësi Metushi, Merkaj, Rustemaj	8602	23/99+2-1	75	64.4	10,174.00	47854	763,050	3,081,797.60	3,844,848	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Efekti shtesë për këtë pasuri është 984 067.2 lekë (vlerësimi shtesë për 15.1 m ² banesë dhe 75 m ² truall).
VLERA TOTALE										3,844,847.60	

Shënime:

Çmimi i apartamenteve është marrë nga ZVRPP Vlorë ku në ZK 8602 është 58,028 lekë/m².

Çmimi i truallit në ZK. 8602 është 10174 lekë/m².